

KUJDESI PËR SHËNDETIN

NE në SIGAL UNIQA, nën moton “të parandalosh është më mirë se të kurosh”, punojmë që nëpërmjet produkteve tona të promovojmë kujdesin e hershëm shëndetësor me tarifa të përballueshme. Të shkosh tek mjeku apo të kryesh analiza edhe nëse nuk të shqetëson ndonjë problem është hapi i parë dhe më i rëndësishëm për këdo që dëshiron t’i identifikojë sëmundjet në kohë.

PËRSE JU SHËRBEN KARTA E KUJDESIT SHËNDETËSOR?

Kujdesi për shëndetin është pjesë e mënyrës sonë të jetesës dhe jo rrallë vendimi për t’u kujdesur për shëndetin merret në raste të caktuara, si për shembull kur kemi një mik apo të afërm të sëmurë, në fillim të vitit, kur bëhemi prindër, apo si dhuratë që i bëjmë vehtes apo të dashurve tanë për ditëlindje. Për ta thjeshtuar këtë vendim dhe në mënyrë që gjithësecili nga ne të kryejë disa analiza bazike, të paktën njëherë në vit, SIGAL UNIQA në bashkëpunim me spitalin me të ri privat në Tiranë, Spitalin Continental, ofron kartën e kujdesit shëndetësor.

ÇFARË MBULON KARTA E KUJDESIT SHËNDETËSOR?

Karta e kujdesit shëndetësor mund të blihet për çdo person, pavarësisht moshës, duke filluar nga 0 vjeç. Karta nuk ka asnjë përjashtim për diagnoza paraekzistuese apo kronike, ajo mund të përdoret nga gjithësecili sipas përshkrimit më poshtë:

- ✓ 1 check up në vit për çdo person të antarësuar;
- ✓ 50% zbritje për 5 vizita me mjekë specialistë;
- ✓ 50% zbritje për ekzaminime laboratorike dhe imazherike;
- ✓ 40% zbritje për ekzaminime me radiologji të avancuar (CT, MRI)

SI MUND TA AKTIVIZOJ KARTËN E KUJDESIT SHËNDETËSOR?

Ju mund ta blini kartën e kujdesit shëndetësor online në www.sigal.com.al ose në çdo degë të SIGAL UNIQA.

Karta është me afat 1 vjeçar nga data e blerjes. Karta nuk përmban emër dhe mbiemër të personit që do ta zotërojë, në këtë mënyrë kjo kartë mund të jetë një dhuratë për një të afërm ose një mbështetje për atë person në familje që do të ketë nevojë ta përdorë gjatë vitit.

Shembull: Nëse individ X ka blerë një kartë të kujdesit shëndetësor SIGAL – Spitali Continental, që nga dita e parë e blerjes karta është aktive. Karta do të skadojë pas 364 ditësh nga data e blerjes. Menjëherë dhe pas çdo blerje, SIGAL do të njoftojë spitalin për numrat serialë të kartave aktive.

Karta nuk ka zotërues, zotëruesi i saj do të jetë personi i parë që merr shërbime pranë Spitalit Continental.

Në momentin që personi XXXX YYYYY paraqitet në spital me kartën e kujdesit shëndetësor si edhe një ID, Spitali e regjistron anëtarin si pacient, dhe karta nga ky moment i përket vetëm pacientit të regjistruar. 1 muaj para skadimit të kartës, Ju, blerësi i kartës, informoheni me një e-mail ose sms për rinovimin e saj.

UDHËZIME TË VLEFSHME

Paraqituni në spital, gjithmonë pasi të keni rezervuar një orar me spitalin në numrat mbrapa kartës tuaj; Rezervimin duhet ta kryeni duke u identifikuar si mbajtës i kartës dhe duke cilësuar nr. serial të saj, në mënyrë që stafi i spitalit t’ju japë udhëzime konkrete;

Pyesni stafin e spitalit nëse analiza, vizita apo ekzaminimi që duhet/dëshironi të kryeni kërkon parapërgatitje specifike;

Nëse për rezervimin e orarit hasni vonesa apo neglizhencë të pa justifikuar, kontaktoni menjëherë me SIGAL UNIQA në numrat apo adresën e e-mailit mbrapa kartës tuaj.